

Aneksi A**SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Ekspert (për Makerspace/ Fab Lab)	Qendra e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes	Tiranë	Pa afat	Po	Po	13.06.2024	27.06.2024

Formulari nr. 1

1.Pozicioni i punës: Ekspert (për Makerspace/Fab Lab), në Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes
2. Kodi i pozicionit: N/A
3. Reparti/Institucioni: Qendra e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes
4. Vendi: Tiranë
5. Paga: VKM nr.325, datë 31.05.2023, i ndryshuar (II-1)
6. Lloji i kontratës së punës: Pa afat
7. Data e fillimit të aplikimit: 13.06.2024
8. Data e mbylljes së aplikimit: 27.06.2024
9. Mënyra e aplikimit: Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën www.mod.gov.al . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës,do të dërgohet në: <i>Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</i> <i>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës</i> <i>Tiranë</i>
10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar sëbashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV)
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike www.mod.gov.al.(linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: Ekspert (për Makers Space/Fab Lab), në Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes.
- b. Arsimi : Të ketë diplomë të nivelit “Master i shkencave” në fushën e Teknologjisë së Informacionit, Inxhinieri Mekanike/ Inxhinieri Elektronike/ Shkenca kompjuterike apo fusha të ngjashme me veprimtarinë e Makerspace/FabLab.
- c. Kualifikimi: Të ketë kualifikime në fushën e mësipërme.
- d. Trajnimi: Të ketë kryer trajnime të tjera në fushën e mësipërme.
- e. Eksperienca në Punë: **Eksperiençë 5 vjeçare në projektimin dhe realizimin e prototipave duke përdorur pajisje si printerë 3D, makineri për prerje lazeri, vegla elektronike etj.**
- f. Gjuha e huaj: Anglisht
- g. Kërkesa të tjera specifike: Aftësi në softuerët e dizajnit 2D dhe 3D si autodesk 3ds max,

Maya ose Blender, së bashku me mjetet për dizajnin për prodhim dhe përgatitjen e printimit 3D. Njohuri të veglave dhe makinerive të ndryshme si prerëse lazer, printera 3D dhe pajisje për prototipimin elektronik. Njohja me materiale të ndryshme (dru, metal, plastikë) dhe vetitë e tyre për zgjedhjen e materialit të duhur për projekte specifike. Aftësia për të identifikuar dhe rregulluar problemet me veglat dhe makineritë, duke e mbajtur laboratorin të funksionojë pa probleme. Eksperienca në programimin e mikrokontrollerëve dhe sistemeve të integruara si Arduino, Raspberry Pi etj.

- h. Niveli i certifikatës së sigurisë: Te plotesoje kriteret për tu pajisur me certifikate të sigurimit të personelit, sipas VKM nr.188/2015. Certifikate Sigurie “Secret”.

- **Përshkrimi i punës:**

Detyrat kryesore:

- Bashkëpunon me ekspertët e tjerë për ofrimin e Fab Lab për start-up’et, Forcat e Armatosura dhe individë/organizata të interesuara nga jashtë qendrës sipas një kalendari të përcaktuar dhe të miratuar.
- Siguron dhe monitoron procesin e aksesit për individët e interesuar që bëhen pjesë e FabLab-it.
- Garanton funksionimin e pajisjeve në Fab Lab, përfshirë instalimin, operimin dhe mirëmbajtjen e tyre.
- Harton, implementon dhe menaxhon planin e punës për Makerspace/Fab Lab-in, duke përfshirë organizimin e aktiviteteve dhe trajnimeve të ndryshme.
- Trajnon ekipin e qendrës dhe të të interesuarve nga jashtë për përdorimin e pajisjeve të Fab Lab-it, duke siguruar njohuri dhe kompetenca të nevojshme.
- Realizon testime dhe eksperimente për aplikimin e teknologjive të reja, produkteve industriale dhe shërbimeve me rëndësi strategjike në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.
- Krijon dhe menaxhon bazat e të dhënave dhe informacioneve për të cilat është përgjegjës, duke siguruar që të dhënat të jenë të përdorshme dhe të aksesueshme.
- Paraqet raporte të qarta dhe të rregullta për statusin e zhvillimit të trajnimeve, seminareve, nevojave dhe detaje të tjera relevante për menaxhimin e Fab Lab-it.
- Ofron mbështetje teknike dhe diskutime me kolegët dhe eprorët gjatë fazës së zbatimit të projekteve.
- Është përgjegjës për krijimin e dokumentacionit teknik për projektet e zhvilluara në Fab Lab dhe përshkruan proceset dhe rezultatet me detaje.
- Raporton në mënyrë periodike tek eprori direkt për zhvillimet e reja në Qendër.
- Kryen detyra të tjera përkatëse që i ngarkohen nga drejtori i qendrës.

13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin ejetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Intervista zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilin profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilin profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Kandidatët të cilët nuk marrin më shumë se **70 pikë**, (që përfshin vlerësimin e dokumenteve të

kandidatëve, si dhe vlerësimin e intervistës), s'kualifikohen nga konkurimi.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.